

VENDIM
Nr. 957, datë 7.12.2016

**PËR PAGESËN E KOSTOS FINANCIARE TË SISTEMIT TË IDENTIFIKIMIT
DHE
TË REGJISTRIMIT TË KAFSHËVE E FERMAVE BLEGTORALE NGA
FERMERËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, nenit 7, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011,
“Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936,
datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kafshët dhe fermat blegtorale identifikohen dhe regjistrohen sipas sistemit kombëtar të identifikimit dhe të regjistrimit (IR), të mbajtur nga autoriteti kompetent, që është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e këtij sistemi.
 2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e më poshtëm kuptojnë:
 - a) “Fërmer”, çdo person fizik apo juridik që ka në pronësi kafshët;
 - b) Pagesa e shërbimit për vendosjen e matrikujve dhe plotësimin e formularit përkatës nga operatori, që bazohet në tarifën e miratuar me udhëzim të ministrit.
 6. Pagesa, nga fermerët, për bazën materiale të sistemit të identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e të fermave blegtorale, e kryer në çastin e matrikullimit të kafshës, sipas pikës 3 të këtij vendimi, depozitohet e dokumentuar financiarisht nga operatori privat, në llogarinë e ministrit.
 7. Pagesa për shërbimin e vendosjes së matrikujve i paguhet, drejtpërdrejt, operatorit privat nga fermeri.
 8. Vlerat financiare, të depozituara nga operatori privat i kontraktuar në buxhetin e ministrit, do të trajtohen si të ardhura jashtë limitit. Administrimi i këtyre të ardhurave bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore dhe do të përdoret për blerjen e bazës materiale për sistemin e identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e të fermave blegtorale, në bazë të procedurave të prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi dhe urdhrit të ministrit.
 9. Vendimi nr. 320, datë 19.3.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, shfuqizohet.
 10. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

b) “Bazë materiale për procesin e identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e fermave blegtorale”, matrikujt për matrikullimin e kafshëve, regjistrat, pasaportat, kartelat dhe formularët për regjistrimin e kafshëve;

c) “Operator privat”, personi fizik ose juridik, i kontraktuar nga autoriteti kompetent, sipas procedurave të prokurimit publik në fuqi, për zbatimin në terren të identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve.

3. Fermerët, për sistemin e identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve e të fermave blegtorale,

që lidhet me pagesën e vlerës së bazës materiale për identifikimin dhe regjistrimin e kafshë si dhe me shërbimin e kryer nga operatorët privatë për vendosjen e matrikujve, paguajnë pjesën e kostos

financiare duke filluar nga data 1 janar e vitit 2017.

4. Fermerët, për shërbimin e ofruar për matrikullimin e kafshëve, kryejnë pagesën e dokumentuar financiarisht drejtpërdrejt tek operatori privat i kontraktuar.

5. Vlerat për pagesat, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, përcaktohen, si më poshtë vijon:

a) Pagesa për bazën materiale të identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve, që bazohet në koston e çmimit të bazës materiale të realizuar nga ministria, nëpërmjet procedurës së prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi;